

# BULETIN VJETOR

## për krimet nga urrejtja

PËR VITIN 2022

Veprat penale të motivuara nga intoleranca, respektivisht paragjykimet ndaj një grupi të caktuar në shoqëri, cilësohen si vepra penale të urrejtjes. Për ekzistimin e këtij lloji të veprës duhet të plotësohen dy kushte: vepra të jetë e paraparë në të drejtën penale dhe akti të jetë i motivuar nga ndonjë paragjykim. Misioni i OSBE-së në Shkup mbështet Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në regjistrimin dhe hartimin e krimeve të urrejtjes. Ky buletin vjetor ofron një shfaqje të të gjitha incidenteve të regjistruara gjatë vitit 2022.

## INCIDENTE

Numri total i  
incidenteve në  
vitin 2022

160

### LLOJI I INCIDENTIT

14

Dëmtim prone

2

Dëmtim simbolesh

20

Lëndim trupor dhe  
lëndim i rëndë

5

Vjedhje

2

Shkaktim i rrezikut  
të përgjithshëm

116

Dhunë

2

Kërcënim serioz

2

Kërcënim i sigurisë

6

Nxitja e urrejtjes në  
bazë nacionaliteti, race  
apo religjioni, përçarjes  
ose intolerancës

\*Numri i përgjithshëm i incidenteve nuk korrespondon gjithmonë me llojin e incidenteve dhe përgjindjet për karakteristikat e viktimave, sepse disa incidente përmbajnë lloje të shumta lëndimesh dhe/ose ndodhin për arsye të shumta.

## KARAKTERISTIKAT E VIKTIMËS

83.75%

Përkatësia  
etnike

1.25%

Përkatësia  
fetare

3.75%

Përkatësia  
politike

1.25%

Orientimi seksual  
dhe identiteti  
gjinor

10%

Tjetër

Numri total i incidenteve në vitin 2022: 160



## INCIDENTET SIPAS VENDNDODHJES

Shkup dhe komunat përreth 118

Tetovë 10

Manastir 6

Gostivar 5

Ohër 5

Kumanovë 4

Gjvgjeli 3

Prilep 3

Radovish 2

Koçan 1

Strugë 1

Shtip 1

Strumicë 1



## INCIDENTE TË IZOLUARA

Më 8 gusht 2022, në qendër të Strumicës është sulmuar fizikisht një aktivist LGBTI+, ku ndodhje me vullnetarë në një aktivitet publik për promovimin e organizatës së tyre. Një mashkull i rritur fillor ta kërcëronte drejtpërdrejt dhe t'i gjuante fjalë fyese, pas së cilit ai u nxitua dhe i shkaktoi lëndime fizike, kurse grupi i vullnetarëve (eve) nga frika u larguan nga vendi i ngjarjes. Pas dorëzimit të aktakuzës në Gjykatën Themelore në Strumicë, gjykata më 28 nëntor 2022 ka nxjerrë aktgjykim në bazë të fajësise, me të cilin është vërtetuar se me sulmin fizik ndaj aktivistit LGBTI+ i motivuar nga orientimi i tij seksual, autori ka kryer veprën penale të: i "Lëndimit trupor" nga neni 130 paragrafi 3 i Kodit Penal, c.v. paragrafi 2 dhe paragrafi 1 i të njëjtit nen.

Më 28.09.2022, një i mitur 17 vjeçar nga fshati Haraçinë ka raportuar se është sulmuar fizikisht nga një i mitur tjetër, në autobusin e NQP-së në fshatin Singeliç, i cili ka tentuar ta sulmojë edhe me objekt të mprehtë.

Më 13.11.2022, zyrtarë policorë nga Njësi policorë për intervenim në SPB Shkup, i kanë privuar nga liria personat LB (18), BM (19), V.H. (19) dhe dy të mitur të tjerë, pasi në autobusin nr:57 kanë sulmuar fizikisht katër të mitur, në një stacion autobusi në Çair.

## REAGIME

4

Numri total i  
reagimeve në  
vitin 2022

### LLOJI I REAGIMIT

3

Nga funksionarë

0

Udhëheqës fetar

1

Shoqatë qytetare

0

Protestë

0

Mënjanimi i pasojave

0

Tjetër

## NGA JANARI 2022

26 : 134

Raste me tregues të qartë të  
njëanshmërisë

Incidente të mundshme\*

\*incidente me tregues të caktuar, por Komiteti i Helsinkit nuk ishte në gjendje të konfirmonte nëse ishin vërtet krime të urrejtjes

## PËRGJIGJJA INSTITUCIONALE

Autorë të zbuluar .....7  
Kallëzime penale .....11  
Kallëzime për kundërvajtje .....0  
Gjykime në vijim e sipër .....2

# PËRFUNDIME

- Numri i incidenteve të raportuara dhe krimeve të mundshme të urrejtjes në vitin 2022 u rrit me 34% krahasuar me vitin 2020 dhe 49% krahasuar me vitin 2021;
- Incidentet sipas përkatësisë etnike janë akoma më të përhapurit me 83.75% të numrit të përgjithshëm të incidenteve të regjistruara;
- Të rinjtë janë ende më shpesh të përfshirë në incidente të motivuara nga paragjykimi, si autorë ashtu edhe si viktimat, duke përfaqësuar 46% të numrit total të incidenteve të regjistruara;
- Megjithëse po ndërmerren hapa të caktuar për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI+, ata janë ende në rrezik më të madh të akteve të motivuara nga paragjykimi, veçanërisht gjatë dhe pas zhvillimit të Paradës së Krenarisë. Megjithatë, po vërehen ndryshime të caktuara në shoqëri, siç tregohet nga fakti se komuniteti LGBTI+ inkurajohet gjithnjë e më shumë të kontaktojë organizatat joqeveritare që punojnë në këtë fushë dhe të përdorin shërbimet e tyre, si mbështetja dhe ndihma juridike falas. Një ndikim të rëndësishëm në rritjen e besimit tek komuniteti LGBTI+ është edhe vendimi pozitiv i gjykatës me të cilin një autor i krimit të urrejtjes bazuar në orientimin seksual u dënua me gjashtë muaj burg;
- Ende nuk mbahen statistika adekuate nga autoritetet kompetente për incidentet e motivuara nga njëanshmëria. Edhe pse Ministria e Punëve të Brendshme mban dhe publikon disa statistika në raportet e saj vjetore, megjithatë, duket se raportet nuk bëjnë një dallim të qartë ndërmjet gjuhës së urrejtjes dhe akteve të urrejtjes. Po ashtu, nuk ka informata lidhur me veprimet e ndërmarra pas dorëzimit të kallëzimit penal nga Ministria e Punëve të Brendshme në Prokurorinë Publike;
- Shumë pak përpjekje janë bërë për të futur masa parandaluese, përfshirë edukimin për të drejtat e njeriut dhe ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut, veçanërisht të nxënësit e shkollave të mesme dhe të rinjtë, duke qenë se shumica e viktimave janë të mitur ose të rinj;
- Motivi i paragjykimit, në vend që të transferohet nga policia në prokurori dhe më pas në gjykata, si një element kyç në rastet e krimeve të urrejtjes, ky motiv "zhduket" gjatë gjithë procesit;
- Duke pasur parasysh faktin se fenomeni i krimit të urrejtjes nuk trajtohet si çështje më vete, shteti nuk ofron mbrojtje dhe mbështetje të veçantë për viktimat. Megjithatë, progres i dukshëm është arritur me miratimin e Ligjit për pagesën e kompensimit monetar për viktimat e krimeve të dhunshme në nëntor të vitit 2022.

## REKOMANDIME

- Hetimi dhe ndjekja efektive dhe në kohë e krimeve të urrejtjes, me motive të njëanshme që merren parasysh gjatë procedimit penal;
- Marrja e masave të duhura për të lehtësuar raportimin e krimeve të urrejtjes nga viktimat, duke përfshirë masat për të forcuar besimin në polici dhe institucionet e tjera shtetërore;
- Mbledhja dhe publikimi i të dhënave gjithëpërfshirëse dhe krahasuese për krimet e urrejtjes, për aq sa është e mundur, si dhe për numrin e këtyre incidenteve të raportuara nga publiku dhe të regjistruara nga autoritetet policore, numrin e dënimeve, motivet e njëanshme pas këtyre krimeve dhe dënimit e shqiptuara;
- Vendosja dhe vazhdimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe organizatave joqeveritare për aspekte të ndryshme të punës për t'u ballafaquar me krimet e urrejtjes, si trajnimi, mbështetja e viktimave dhe rritja e shkallës së raportimit;
- Ky bashkëpunim duhet të bazohet në shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit, veprimin e përbashkët në drejtim të zbulimit të motiveve të njëanshme, bashkëpunimin për zhvillimin e udhëzimeve, rregullave dhe trajnimeve për regjistrimin e incidenteve të urrejtjes, duke përfshirë shkëmbimin e ekspertizës për zhvillimin, përmirësimin dhe rishikimin e treguesve të njëanshëm;

- Sigurimi i mbështetjes dhe mbrojtjes për viktimat e krimeve të urrejtjes;
- Përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit ndërmjet të gjitha autoriteteve dhe institucioneve kompetente në fushën e krimeve të urrejtjes;
- Kryerja e hulumtimeve në nivel kombëtar të masave për trajtimin e krimeve të urrejtjes, si burim kyç informacioni për përfaqësimin e krimeve të urrejtjes në vend;
- Promovimi i trajnimeve për institucionet përkatëse që vijnë në kontakt me viktimat e krimit të urrejtjes, në mënyrë që ato t'i ndihmojnë në mënyrë efektive;
- Më shumë masa parandaluese, ndër të tjera duke rikthyer konceptin e të mbajturit mend në edukimin për të drejtat e njeriut, kurrikulat e historisë dhe trajnimet përkatëse, duke ndërmarrë hapa për edukimin e publikut, veçanërisht të miturve dhe të rinjve për vlerat e diversitetit dhe përfshirjes kulturore, si dhe përpjekjet nga të gjithë sektorët nga shoqëria të kenë një rol në luftën kundër një intolrance të tillë.